

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.G. , nga fshati ..., Komuna Prishtinës , për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par. 4 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK-ës , duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.387/13, datë 23.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së të akuzuarit N.G. , ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë , P.nr.387/13, datë 23.01.2018, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit N.G. përkitazi për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par. 4 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK-ës, për të cilën është shpallur fajtor, e refuzon akuzën në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 91 par. 6 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

III. Lidhur me kërkesën pasurore- juridike të palës së dëmtuar, aktgjykimi i ankimuar ngel i pandryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin , P.nr.387/13, datë 23.01.2018 , të akuzuarin N.G. , e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par. 4 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK-ës, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh e i dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këti aktgjykimi nuk kryen vepër të re penale. Është obliguar i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këti aktgjykimi. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i akuzuari N.G. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vendimin mbi shpenzimet procedurale dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta refuzoj aktakuzën për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.379/18, datës 27.04.2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet aktakuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, gjeti se:

-Me aprovimin e ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet ndryshuar sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del se i akuzuari N.G., është shpallur fajtorë dhe gjykuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par. 4 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPK-ës (i cili ishte në fuqi gjatë kohës kur është kryer vepra penale), për të cilat parashihet dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 3 (tri) vite. Sipas dispozitës së nenit 90 par.1 pika 5 të KPK-së, për vepër penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vitë burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tri) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se vepra penale nga i akuzuari është kryer më datë 15.02.2012, kurse afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale, ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale e deri në arritjen e lëndës me ankesë në Gjykatën e Apelit me datën 10.04.2018, (gjyqtarit të çështjes i është dorëzuar me 10.05.2018), kanë kaluar me shumë se 6 (gjashtë) vite, nga këto arsye aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç'arsye ankesa e të akuzuarit është aprovuar si e bazuar. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 454 par. 1 të KPPK-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.371/18, datë 14.05.2018

Zyrtari ligjor
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq